



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 61, datë 29.03.2018

PËR

**MIRATIMIN E LICENCIMIT TË ZJ. ARMIDA LIKA, PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME PËR KLASAT E JETËS DHE JO-JETËS**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 209 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin zj. Armida Lika për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime, në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

EKZEKUTIV

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ervin KOÇI